

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega kryetar, Mejreme Zekaj dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Zymrije Çunaku, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr.regj.19218/12, datë 15.10.2012, në bazë të nenit 39,219 dhe 220 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 12.12.2012 merr

AKTVENDIM

REFUZOHET ankesa e paraqitur si e **PABAZUAR**.

VËRTETOHET aktvendimi i atakuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

REPUBLICA E KOSOVËS AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT ANTI-CORRUPTION AGENCY	
DPK/DMP	Nr. Prot. 03-4580/12
02	Data 21.12.2012

Arsyetim

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, sipas aktvendimit Nr.regj.18218/12, datë 15.10.2012, të pandehurin Burim Qorri nga Drenasi, e ka shpallur përgjegjës sepse si Zyrtarë i Lartë Publik, në pozitë sekretar i parë në Ambasadën e Kosovës në Tiranë, nuk e ka bërë deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor më 31.03.2012, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtarëve të Lartë Publik, dhe i ka shqiptuar masën e QORTIMIT.

Kundër këtij aktvendimi Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, ka paraqitur ankesë për shkak të:

-vendimit mbi dënimin.

Në arsyetim të ankesë përpos tjerash thekson se gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në nenin 10 të Ligjit për Kundërvajtjet të pandehurit i ka shqiptuar masën e qortimit duke e arsyetuar se i pandehuri çdo herë e ka përmbushur obligimin e tij për deklarin e pasurisë kurse këtë herë është vonuar, se nuk janë marr për bazë faktet relevante dhe rrethanat tjera të cila kanë parë ndikim të drejtpërdrejtë në kryerjen e kundërvajtjes ngase kjo vepër kërkon një përgjegjësi të lartë publike dhe se i pandehuri këtë obligim ka mundur ta kryej edhe përmes e-mali-it kështu konsideron që gjykata e shkallës së parë nuk ka shqiptuar dënim të merituar por të njëjtin e ka zbutur në masë të madhe në kundërshtim me rregullat për zbutjen e dënimit nga neni 9 i Ligjit mbi Kundërvajtjet pa arsye të justifikueshme për një zbutje të këtillë të dënimit.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e atakuar, deklarin e të pandehurit të dhënë në seancën e shqyrtimit pranë gjykatës së shkallës së parë më datë 12.06.2012 si dhe nga dëshmia e dëshmitarit Enis Sadiku të dhënë më datë 15.06.2012, por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, padyshim është vërtetuar gjendja faktike se i pandehuri e ka plotësuar formularin për deklarin e pasurisë më 30. mars 2012 por në Agjencion ka arritur me vonesë disa ditësh gjegjësisht më 05.04.2012 d.m.th. para marrjes së aktvendimit dhe para fillimit të procedurës kundërvajtëse për çka me të drejtë i është shqiptuar masa e qortimit, kurse thëniet ankimore të ushtruesit të kërkesës se vendimi mbi dënimin është marr në vështrim të nenit 9 të LK-së, nuk janë të bazuar ngase gjykata e shkallës së parë me rastin e

03-4580/12/02
feng

2.

shqiptimit të dënimit të të pandehurit nuk e ka aplikuar nenin 9 të LK-së por duke marr parasysh se i pandehuri ka kryer kundërvajtje por nuk ka shkaktuar pasoja, edhe me shqiptimin e qortimit do të arrihej qëllimi ndëshkimor që të ardhmen mos të kryej kundërvajtje të tilla apo të ngjashme, andaj ankesa e parashtruar nga Agjencia Kundër Korrupsionit është e pabazuar, ndërkaq aktvendimi i atakuar vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.


Nga sa u tha më lartë në vështrim të nenit 220 të Ligjit mbi Kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.

GJL.nr.1409/2012 të datës 12.12.2012.

SEK. JURIDIKE,
Zymrije Çunaku



KRYETARI I KOLEGJIT,
Dalip Bega